



Datë: 21.07.2025
Numër Protokolli: 5012/2025

A.nr.976/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.976/2025, të datës 27.05.2025, të parashtruar nga ankuesi G.H, kundër organit të punësimit/Agjencia e Statistikave të Kosovës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 21.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.976/2025, e datës 27.05.2025, e parashtruar nga ankuesi G.H.

A r s y e t i m

Ankuesi, G.H (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 27.05.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur, Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit, të shpallur sipas Konkursit me numër reference RN00016894, më datë 28.02.2025, nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, për pozitën e punës Zyrtar për Logjistikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) duke ju referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesi me datë 27.05.2025, **është e palejuar**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Agjencia e Statistikave të Kosovës, më datë 28.02.2025, ka shpallur konkursin me numër reference RN00016894, për pozitën e punës Zyrtar për Logjistikë, me afat aplikimi nga data 01.03.2025 deri më datë 30.03.2025.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë 56 kandidatë, ndërsa prej tyre, kriteret e konkursit i kanë plotësuar dhe kanë hyrë në liste të ngushtë 38 kandidatë, në mesin e tyre edhe ankuesi, i cili sipas shkresave të lëndës rezulton se nuk ka marrë pjesë në vlerësimin profesional të kandidatëve, përkatësisht në testin me shkrim.

Ndërsa, sipas Njoftimit me numër protokolli 03-01-584 të datës 08.05.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burime Njerëzore në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, rezulton se kandidati G.V, me gjithsejtë 82.6 pikë, kandidatja D.G me gjithsejtë 77 pikë, kandidati B.R me gjithsejtë 74.6 pikë dhe kandidati B.S me gjithsejtë 74.4, janë shpallur kandidatë fituese për pozitën e punës *Zyrtar për Logjistikë*.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se shpallja e konkursit është në kundërshtim me nenin 5 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil, ngase nuk është specifikuar saktë vendi i punës, dhe në vend të kësaj është shkruar Profesional 2, andaj i njëjti kërkon shqyrtimin e ligjshmërisë së kësaj shpallje, të vlerësoj nëse mungesa e specifikimit të vendit të punës e bën shpalljen të pavlefshme dhe të rekomandoj rishpalljen e konkursit në përputhje me legjislacionin në fuqi, nëse konstatohet shkelje ligjore.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmerinë e ankesës iu referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 27 paragrafi 4 ku përcaktohet se: *“4. E drejta e ankimit në KPMSHCK i njihet edhe çdo kandidateje/i në procedurë pranimi në shërbimin civil”*, si dhe dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 14 ku përcaktohet se *“Palë në procedurën administrative mund të jetë çdo person fizik, person juridik apo grup personash me një interes të përbashkët: 1.1. me kërkesë të të cilit organi publik ka filluar procedura administrative; 1.2. ndaj të cilit ka filluar procedura administrative apo të cilit rezultati i procedurës administrative mund t'i cenohet të drejtat apo interesat juridike. 2. Palë në procedurën administrative janë, gjithashtu, dhe mbrojtësit e interesave publike të autorizuar me ligj të veçantë, si dhe mbrojtësit e interesave kolektive apo të interesave të gjera të publikut, nëse këto interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative”*, nenit 103 paragrafi 2, ku përcaktohet se: *“2. Procedura administrative e nisur sipas kërkesës, gjithashtu do të përfundohej, kur nga rrethanat rezulton pa asnjë dyshim se pala nuk ka më interes në vazhdimin e saj dhe e ka braktisur atë”*, si dhe nenit 124 paragrafi 1, të të njëjtit ligj me të cilin parashihet se: *“Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim,”*, dhe si rrjedhojë referuar dispozitave përkatëse ligjore, Kolegji i Këshillit, konstaton se me zhvillimin e procedurës përkatëse të rekrutimit, gjegjësisht me mos vendosjen e vendit të punës në procedurën e rekrutimit me numër reference RN00016894, ankuesit nuk është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik lidhur me kandidimin e tij për pozitën Zyrtar për Logjistikë, ngase i njëjti duke qenë se ka kaluar fazën e verifikimit, sipas shkresave të lëndës, përkatësisht përmes e-mailit të datës 15.04.2025, konstatohet se është ftuar nga Njësia për Menaxhimin e Burime Njerëzore e ASK-së për mbajtjen e testit me shkrim të datës 25.04.2024, mirëpo edhe pse i njëjti nga shkresat e lëndës rezulton se nuk ka marrë pjesë në testin me shkrim, nga rrjedhë se ankuesi me vetë dëshirë e ka braktisur pjesëmarrjen në procedurën përkatëse të rekrutimit, dhe si rrjedhojë i njëjti nuk ka legjitimitetin e palës në këtë çështje juridiko-administrative, dhe rrjedhimisht në mungesë të legjitimitetit të palës ankesa A.nr.976/2025 është e palejuar në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që, për sa me sipër, Kolegji konstaton se në rrethanat e rastit konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore për pranueshmerinë e ankesës në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 ndërlidhur me nenin 125 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe se duke u mbështetur në dispozitat e nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji

vendosi që të hedhë poshtë ankesën si të palejueshme, siç është përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.976/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit, G.H;
- Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Statistikave të Kosovës; si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.